



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 657/4 prot.

Datë 11.04.2023

V E N D I M
Nr. 264/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.04.2023, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 657 prot., datë 29.03.2023 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-60400-02-27-2023, me objekt: “*Blerje material pastrimi*”, me fond limit 2.403.800 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau i Dejes.

Ankimues: Operatori ekonomik “Anbim” SHPK
Rruga “Muhamet Gjollesha”, Pll.3, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vau i Dejes
Rruga “Qafa e Gurit”, Vau Dejes

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Xhovan Gjini” PF
Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga “Dritan Hoxha”, Zona Kadastrale 8210, mbrapa Ring Center, Tiranë

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.202 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.02.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-60400-02-27-2023, me objekt: “Blerje material pastrimi”, me fond limit 2.403.800 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau i Dejes.

II.2. Në datën 29.03.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. protokollit 657 datë 29.03.2023 e operatorit ekonomik “Anbim” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Anbim” SHPK, si dhe me vendimmarrjen

e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Xhovan Gjini” PF në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 657/2 prot., datë 30.03.2023, u publikuan arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Anbim” SHPK, si dhe pretendimet mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Xhovan Gjini” PF pjesmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit

II.4. Në datën 11.04.2023, operatori ekonomik ankimues “Anbim” SHPK, me anë të shkresës së protokolluar pranë KPP-së, me nr. 657/3 prot., datë 11.04.2023, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-60400-02-27-2023, me objekt: “*Blerje material pastrimi*”, me fond limit 2.403.800 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau i Dejes. Konkretisht në deklaratë citohet: “*...Shoqëria Anbim shpk ka paraqitur ankesë për procedurën e prokurimit me Nr REF 60400-02-27-2023 të zhvilluar nga autoriteti kontraktor Bashkia Vau Dejes me objekt blerje material pastrimi e protokolluar pranë jush me nr prot 657 dt 29.03.2023. Për arsye të defekteve në linjat e prodhimit dhe efekt kohe shohim vështirësi në realizimin e saj nqs do të kualifikoheshim. Nisur sa thamë më sipër tërhiqemi nga ankesa.*”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “Anbim” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-60400-02-27-2023, me objekt: “*Blerje material pastrimi*”, me fond limit 2.403.800 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau i Dejes, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës nr. 657 prot., datë 29.03.2023 për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-60400-02-27-2023, me objekt: “*Blerje material pastrimi*”, me fond limit 2.403.800 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau i Dejes.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro